



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 07.07.2020)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 28.05.2020”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (vijon shqyrtimi nga mbledhja e datës 2 korrik 2020).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:10 dhe mbaroi në orën 13:05.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

**10. Erjon Muharremaj** (anëtar)

**11. Marçela Shehu** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.**
- 2. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
- 3. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë (nëpërmjet platformës).**
- 4. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID (nëpërmjet platformës).**

#### **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 28.05.2020”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (vijon shqyrtimi nga mbledhja e datës 2 korrik 2020).

**Naureda Llagami:** Meqenëse të gjithë anëtarët e Këshillit janë prezent, po fillojmë mbledhjen e radhës të datës 7 korrik 2020.

Siç jeni në dijeni, në rendin e ditës është një çështje për të cilën kërkohet vendimmarrja juaj. Është një çështje të cilën e kemi shqyrtuar në mbledhjen e kaluar.

Jeni dakord me rendin e ditës?

Merr fjalën zonja Ukperaj!

**Brikena Ukperaj:** Unë kisha për të propozuar shtimin e një pike në rendin e ditës, nisur nga një material i përcjellë ditën e djeshme në e-mailin zyrtar nga ana e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe që i referohet trajtimit të kërkesës së gjyqtares {...} për mbarimin e statusit të magjistratit.

Referuar relacionit dhe disa materialeve që së fundmi na janë dërguar edhe në e-mail, gjyqtarja ka kërkuar mbarimin e statusit të magjistratit dhe njëkohësisht ka bërë

edhe një kërkesë që ajo e ka konsideruar të motivuar, për përshpejtimin e efekteve të kësaj dorëheqjeje. Referuar relacionit dhe kërkesës, gjyqtarja ka kërkuar që shkaqet e motivimit janë të lidhura ngushtësisht sipas asaj edhe me afatin e fillimit të efekteve të dorëheqjes jo më vonë se data 08.07.2020. Nisur nga ajo që përshkruhet në relacion por edhe nga qëndrimi që kemi mbajtur edhe në rastet e tjera të trajtimit të dorëheqjeve, shqyrtimi i kësaj dorëheqjeje në një afat më të vonshëm mundet që të sillte perceptime dhe ndoshta konkluzione të ndryshme lidhur me mbarimin e statusit të magjistratit si dhe efektet që do të sillte ky mbarim.

Për këtë arsye, unë vlerësoj që në kushtet kur ne i kemi të gjitha materialet e përcjella nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, të merrnim në shqyrtim edhe kërkesën e zonjës {...} për mbarimin e statusit të magjistratit, në këtë mbledhje plenare.

**Naureda Llagami:** Atëherë, e hedhim në votim shtimin në rendin e ditës të çështjes lidhur me kërkesën për dorëheqje të bërë nga zonja {...}?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, shtohet në rendin e ditës çështja e propozuar nga zonja Ukperaj.

Kalojmë tani në shqyrtimin e çështjes së parë të rendit të ditës, që ka të bëjë me projektvendimin “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e

Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 28.05.2020”. Për më shumë detaje ia kaloj fjalën relatorit zotit Ilir Toska.

***Ilir Toska:*** Faleminderit!

Në mbledhjen plenare të datës 02.07.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor mori në shqyrtim projektvendimin “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor datë 28.05.2020”.

Gjatë shqyrtimit të këtij projektvendimi, Këshilli konstatoi se katër nga kandidatët që kanë kandiduar në procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura me datë 28.05.2020, më herët kishin kandiduar edhe në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë ose në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e shpallura më datë 26.02.2020. Konkretisht:

1) Kandidati z.{...} - ka kandiduar në total për 4 pozicione të lira që janë në proces - për dy pozicione të lira në Gjykatën e Lartë, të shpallura me Vendimet nr. 82 dhe nr. 83, datë 26.02.2020, si dhe për dy pozicione të lira në Gjykatën Administrative të Apelit, të shpallura me Vendimet nr. 187 dhe nr. 188, datë 28.05.2020;

2) Kandidatja znj.{...} - ka kandiduar në total për 5 pozicione të lira që janë në proces - për tre pozicione të lira në Gjykatën e Lartë, të shpallura me Vendimet nr. 82, nr. 83 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, si dhe për dy pozicione të lira në Gjykatën e Apelit Tiranë, të shpallura me Vendimet nr. 179 dhe nr. 180, datë 28.05.2020;

3) Kandidati z.{...} - ka kandiduar në total për 6 pozicione të lira që janë në proces - për tre pozicione të lira në Gjykatën e Lartë, të shpallura me Vendimet nr. 82, nr. 83 dhe nr. 84, datë 26.02.2020, si dhe për tre pozicione të lira në Gjykatën e Apelit Korçë dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, të shpallura respektivisht me Vendimet nr. 176, nr. 187 dhe nr. 188, datë 28.05.2020;

4) Kandidatja znj.{...} - ka kandiduar në total për 4 pozicione të lira që janë në proces - për një pozicion të lirë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të shpallur me Vendimin nr. 91, datë 26.02.2020, si dhe për tre

pozicionet e lira në Gjykatën e Apelit Tiranë, të shpallura me Vendimet nr. 181, nr. 182 dhe nr. 183, datë 28.05.2020.

Gjatë shqyrtimit të projektvendimit si më lart, pasi diskutoi përsëri për kufizimin e të drejtës së kandidimit sipas pikës 6, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, Këshilli mbajti qëndrimin se një gjyqtar mund të kandidojë në jo më shumë se tre pozicione të lira në proces, shkak për të cilin vendosi që katër kandidatët si më sipër, të cilët kishin kandiduar në më shumë se tre pozicione të lira në proces, të ftoheshin për të rikonsideruar, brenda datës 03.07.2020, tre pozicione të lira për të cilat do të vijonin të kandidonin, pra të përcaktonin jo më shumë se tre pozicionet që kanë kandiduar dhe që janë në proces.

Katër kandidatët u njoftuan rregullisht në rrugë elektronike për ftesën e Këshillit dhe, më datë 03.07.2020, në rrugë elektronike, rikonsideruan tre pozicione të lira për të cilat do të vijonin të kandidonin, pra përcaktuan jo më shumë se tre pozicione që kanë kandiduar dhe që janë në proces. Konkretisht:

Kandidati z. {...} është shprehur se "... Meqenëse me vendimet nr. 82, 83 dhe 84, datë 26.02.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka hapur procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative, me qëllim që të shpreh interesin tim për të tre këto pozicione të lira në fushën administrative, ju bëj me dije qëndrimin tim për shprehjen e interesit dhe vazhdimin e procedurave vetëm për dy pozicione të lira në Gjykatën e Lartë, të shpallura me Vendimet nr. 82 dhe nr. 83, datë 26.02.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Heqjen dorë nga kandidimi im për dy pozicionet e lira në Gjykatën Administrative të Apelit, të shpallura me Vendimet nr. 187 dhe nr. 188, datë 28.05.2020";

Kandidatja znj. {...} është shprehur se: "... për zgjedh të vijoj konkurrimin për vakancat në Gjykatën e Lartë në fushën e të drejtës administrative të shpallura me vendimet nr. 82 dhe nr. 83, datë 26.02.2020 dhe vakancën në Gjykatën e Apelit Tiranë, juridiksioni i përgjithshëm në fushën e të drejtës civile shpallur me vendimin nr. 179, datë 28.05.2020";

Kandidati z. {...} është shprehur se: "... saktësoj se vendet vakante në të cilat kërkoj të kandidoj janë: Për pozicionin e lirë si gjyqtar në Gjykatën e Lartë në kolegjin administrativ të shpallur me vendimin nr. 83, datë 26.02.2020 të KLGJ, për pozicionin e lirë si gjyqtar në Gjykatën e Lartë në kolegjin administrative të shpallur me vendimin nr.

82, datë 26.02.2020 të KLGJ dhe për pozicionin e lirë si gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit të shpallur me Vendimin nr. 187, datë 28.05.2020 të KLGJ-së”;

Kandidatja znj. {...} është shprehur se: “Në përgjigje të kërkesës tuaj, ku më ftoni të rikonsideroj kandidaturat e mia, deklaroj se unë heq dorë nga kandidimi në pozicionin e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë, të shpallur me Vendimin nr. 182, datë 28.05.2020”.

Bazuar në vullnetin e katër kandidatëve sipas qëndrimit të shprehur nga ata, përmes kërkesave me shkrim të datës 03.07.2020, të dërguara në rrugë elektronike, rezulton që tashmë të katër ata kanë përcaktuar tre pozicionet e lira në proces për të cilat do të vijnë kandidimin.

Vullneti më i fundit i katër kandidatëve afekton pjesërisht projektvendimin e propozuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, atij “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor datë 28.05.2020”.

Kështu, në pikën 2 të projektvendimit të rishikuar, që bën fjalë për caktimin e relatorit për secilin nga kandidatët për pozicionet e lira, për të cilat fillon procedura e verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit sipas pikës 1 të projektvendimit, ka një saktësim të kandidatëve, ndërsa nuk përcaktohet më si i tillë z. {...}, i cili, sikurse më lart u parashtrua, është tërhequr nga kandidimi për dy pozicionet e lira në Gjykatën Administrative të Apelit.

Në pikën 3 të projektvendimit të rishikuar, që bën fjalë për vlefshmërinë e procedurave të verifikimit në proces sa i përket pasurisë dhe figurës, për kandidatët që kanë kandiduar edhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë ose në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka një saktësim të tyre, ndërsa nuk evidentohet më si kandidat z. {...}, që sikurse u përmend është tërhequr nga kandidimi për pozicionet e lira në Gjykatën Administrative të Apelit.

Pika 4 e projektvendimit të rishikuar është pikë e shtuar dhe bën fjalë për mosfillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 180, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për

kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes nga kandidimi për këtë pozicion më datë 03.07.2020, pra përpara fillimit të procedurës së verifikimit të kandidatëve.

Pika 5 e projektvendimit të rishikuar është pikë e shtuar dhe bën fjalë për mosfillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me Vendimin nr. 176, datë 28.05.2020, si dhe për pozicionin e lirë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 188, datë 28.05.2020, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes nga kandidimi për këto pozicione më datë 03.07.2020, pra përpara fillimit të procedurës së verifikimit të kandidatëve.

Pika 6 e projektvendimit të rishikuar është pikë e shtuar dhe bën fjalë për mosfillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 182, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes nga kandidimi për këtë pozicion më datë 03.07.2020, pra përpara fillimit të procedurës së verifikimit të kandidatëve.

Së fundit, në pikën 7 të projektvendimit të rishikuar (që ka qenë pika 4 sipas projektvendimit fillestar), që bën fjalë për mosfillimin e procedurës së verifikimit për kandidatët që janë tërhequr nga kandidimi për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, ka një saktësim të kandidatëve, ndërsa evidentohet si i tillë edhe z.{...}, i cili sikurse u përmend është tërhequr nga kandidimi për pozicionet e lira në Gjykatën Administrative të Apelit.

Sa i përket tre kandidatëve të tjerë, pra znj. {...}, z. {...} dhe znj. {...}, pas rikonsiderimit nga ata të kandidimeve dhe përcaktimin e tre pozicioneve të lira për të cilat do të vijonin të kandidonin, rezulton që të kenë konsideruar edhe kandidimin në një nga pozicionet e lira në proces në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, shkak për të cilin ata vijnë të jenë përfshirë në pikat 2 dhe 3 të projektvendimit të rishikuar, ndërkohë që për znj. {...} do të duhet të konsiderohet përfundimi i procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me Vendimin nr. 86, datë 26.02.2020, kurse për z. {...} do të duhet të konsiderohet mosfillimin e procedurës së

verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallur me Vendimin nr. 84, datë 26.02.2020. Faleminderit!

Mund të shtoj sa i përket procedurave të shortit. Ndërsa janë 20 kandidatë për të cilët duhet të caktohet relatori, Komisioni propozon që numri i kandidatëve për secilin nga anëtarët e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës të jetë i tillë: për zotin Toro dhe zonjën Shehu të marrin nga 7 kandidatë dhe unë të marrë 6 kandidatë. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Kalojmë tek procedura e shortit dhe më pas në miratimin e të gjithë projekt-aktit. Në një nga vazot do të hidhen emrat e kandidatëve.

Nis procedura e futjes, në enën e qelqit, të shiritave të letrës, me emrat e 20 kandidatëve, sipas kësaj radhe: {...} – {...}; Më pas procedura e futjes në enën tjetër të qelqit, të shiritave të letrës, me emrat e anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës sipas kësaj radhe: z.Alban Toro, z. Ilir Toska dhe znj. Marçela Shehu.

I pari që përzgjidhet është zoti Alban Toro, i cili do të jetë relator për 7 nga kandidatët të cilët do të përzgjidhen nga shorti.

Të përzgjedhur nga shorti, sipas radhës, janë këto kandidatë: {...} – {...}.

I dyti që përzgjidhet është zoti Ilir Toska, i cili do të jetë relator për 6 nga kandidatët të cilët do të përzgjidhen nga shorti.

Të përzgjedhur nga shorti, sipas radhës, janë këto kandidatë: {...} – {...}.

E treta që mbetet është znj. Marçela Shehu, e cila do të jetë relatore për 7 nga kandidatët të cilët do të përzgjidhen nga shorti.

Të përzgjedhur nga shorti, sipas radhës, janë këto kandidatë: {...} – {...}.

**Naureda Llagami:** Atëherë, hedhim në votim projekt-aktin e propozuar nga Komisioni, konkretisht:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr.173, nr.174, nr.176, nr.179,



nr.180, nr.181, nr.182, nr.183, nr.184, nr.185, nr.186, nr.187 dhe nr.188, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:

1. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
2. Për kandidaten znj. {...}, relatore znj. Marçela Shehu;
3. Për kandidaten znj. {...}, relatore znj. Marçela Shehu;
4. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
5. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Ilir Toska;
6. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
7. Për kandidatin z. {...}, relatore znj. Marçela Shehu;
8. Për kandidatin z. {...}, relatore znj. Marçela Shehu;
9. Për kandidatin z. {...}, relator z. Ilir Toska;
10. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
11. Për kandidatin z. {...}, relatore znj. Marçela Shehu;
12. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
13. Për kandidatin z. {...}, relator z. Ilir Toska;
14. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Ilir Toska;
15. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Ilir Toska;
16. Për kandidaten znj. {...}, relatore znj. Marçela Shehu;
17. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
18. Për kandidaten znj. {...}, relatore znj. Marçela Shehu;
19. Për kandidatin z. {...}, relator z. Alban Toro.
20. Për kandidatin z. {...}, relator z. Ilir Toska;

3. Për kandidatët znj.{...}, z.{...} dhe znj.{...}, të cilët kanë kandiduar edhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë ose në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, procedurat e verifikimit sa i përket pasurisë dhe figurës që janë në proces e sipër për këto kandidime, janë të vlefshme edhe për kandidimet e tyre për pozicionet e lira në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm ose në Gjykatën Administrative të Apelit, respektivisht për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr.179, nr.187 dhe nr.181 e nr.183, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

4. Mosfillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr.180, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes nga kandidimi për këtë pozicion më datë 03.07.2020.

5. Mosfillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me Vendimin nr.176, datë 28.05.2020, si dhe për pozicionin e lirë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.188, datë 28.05.2020, për kandidatin z.{...}, për shkak të tërheqjes nga kandidimi për këto pozicione më datë 03.07.2020.

6. Mosfillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr.182, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj.{...}, për shkak të tërheqjes nga kandidimi për këtë pozicion më datë 03.07.2020.

7. Mosfillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor më datë 28.05.2020, për kandidatët znj.{...}, z.{...} dhe z.{...}, në kushtet e tërheqjes së tyre nga kandidimi për pozicionet përkatëse, respektivisht në datat 16.06.2020, 22.06.2020 dhe 03.07.2020.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në votimin e projektvendimit.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Erjon Muharremaj*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Medi Bici*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi vendimin “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 28.05.2020”, sipas propozimit të bërë nga Komisioni përkatës.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 07.07.2020)*

**Pika 2 shtesë e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, znj. {...}”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:10 dhe mbaroi në orën 13:05.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                             |                                 |
|-----------------------------|---------------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b>   | <b><i>(kryetare)</i></b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>       | <b><i>(zëvendëskryetar)</i></b> |
| <b>3. Medi Bici</b>         | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>      | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>     | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b>   | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>7. Ilir Toska</b>        | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>        | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b>   | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>10. Erjon Muharremaj</b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>11. Marçela Shehu</b>    | <b><i>(anëtare)</i></b>         |

Merrnin pjesë gjithashtu:

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor  
Tiranë, më 07.07.2020 (Pika 2 shtesë)***

1. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
2. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
3. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë (nëpërmjet platformës).*
4. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID (nëpërmjet platformës).*

## **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, znj. {...}”.

*Naureda Llagami:* Atëherë, kalojmë në çështjen e shtuar në rendin e ditës e cila ka të bëjë lidhur me mbarimin e statusit të magjistrates për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, znj. {...}, për shkak të dorëheqjes. Fjalën ia jap relatorit të çështjes, i cili është zoti Alban Toro.

*Alban Toro:* Faleminderit!

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 24.06.2020, është depozituar një kërkesë me shkrim nga gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, znj. {...}, nëpërmjet të cilës ajo ka parashtruar dorëheqjen e saj nga statusi i magjistratit.

Me Vendim nr.2 në datën 12.04.1995 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ajo është emëruar si ndihmësgjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me Vendim nr.83 në datën 13.05.2000 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, më pas ajo ka kaluar si gjyqtare pranë Gjykatën së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në kërkesën e saj, më datë 24.06.2020, gjyqtarja znj. {...} ka kërkuar që mbarimi i mandatit të realizohet në parashikim nga neni 65/1 të ligjit nr.96/2016, ku përcaktohet se magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës.

Si motiv të kërkesës së parë znj. {...} ka parashtruar faktin: “Tashmë pas 25 vitesh eksperience në sistemin gjyqësor, një periudhë ndoshta nga më të gjatat në këtë sistem,

unë çmoj se eksperiencia dhe kontributi im duhet të vazhdojë nga katedra akademike e mësimdhënies duke kontribuar sado pak në formimin e brezave të ri të juristeve. Ka ardhur koha që këtë detyrë kaq të lartë dhe të vlerësuar “dhënie e drejtësisë” duhet t’jua lëmë magistratëve të rinj të cilët i kanë të gjithë kapacitetet etiko-morale dhe profesionale që në respektim të Kushtetutës dhe ligjeve të bëjnë Republikën e Shqipërisë një anëtare të denjë të familjes së madhe Evropiane.”

Ndërkohë, më datë 26.06.2020, znj. {...} ka depozituar në Këshillin e Lartë Gjyqësor një kërkesë me shkrim, protokolluar me nr.2925/1, nëpërmjet të cilës, në funksion të dorëheqjes se paraqitur më datë 24.06.2020, ka kërkuar që kjo dorëheqje të jepte efektet “jo më larg se data 08.07.2020”. Si motiv për këtë kërkesë, znj. {...} ka parashtruar “Me anë të kësaj kërkesë për arsyet e mia personale dhe shëndetësore, do të më duhet të udhëtoj pas datës 09.07.2020, ndaj ju kërkoj që efektet e mbarimit të statusit të magistratit të vinin jo më vonë se data 08.07.2020”.

Në lidhje me analizën e moscenimit të interesit publik nga dhënia efekte të dorëheqjes përpara afatit ligjor, është kërkuar informacion në lidhje me proceset gjyqësore. Nga këto të dhëna konstatohet se me cilësinë e gjyqtarës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë znj. {...} deri më datë 29.06.2020 ka 278 çështje gjyqësore.

Më datë 30.06.2020 në kuadër të informacionit të dërguar nga Gjykata së Rrethit Gjyqësor Tiranë është kërkuar informacion shtesë në lidhje me specifikimin e çështjeve që gjyqtarja ka në fazën përfundimtare të shqyrtimit (pra konkluzione përfundimtare ose shpalljen e vendimeve).

Po në të njëjtët datë nga gjykata është përcjellë informacion ku në dijeni të tyre është vetëm një çështje në fazën përfundimtare të shqyrtimi “Çështja me nr. 2619 akti, me palë paditës: Shoqëria Tregtare “Digicom” sh.p.k., i paditur: Shoqëria Tregtare “Lions Car Hire” sh.p.k. objekti: përmbushje e detyrimit kontraktual. Në lidhje me çështjen nr.2619 Akti, bazuar në procesverbalet e seancave të mbajtura për këtë çështje sqarojmë se seanca e datës 09.03.2020 është shtyrë për shpallje vendimi në datë 17.03.2020. Seanca e datës 17.03.2020 nuk u zhvillua për shkak të gjendjes së krijuar nga Covid-19, bazuar kjo edhe në vendimin nr.127, datë 10.03.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Me rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore, gjykata vendosi të caktojë seancën e radhës në datë 19.06.2020. Seanca e datës 19.06.2020 nuk u zhvillua

për shkak se gjyqtarja nuk u paraqit në detyrë për arsye shëndetësore (me raport mjekësor), dhe kjo seance u shty për në datë 24.06.2020. Seanca e datës 24.06.2020 nuk u zhvillua për shkak se gjyqtarja ka depozituar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor kërkesë për dorëheqje nga funksioni i gjyqtarit.”

Më datë 03.07.2020, znj. {...} ka depozituar në Këshillin e Lartë Gjyqësor një tjetër kërkesë me shkrim në funksion të kërkesave të paraqitura me parë të datave 24.06.2020 dhe datë 26.06.2020, protokolluar me nr.2925/2, nëpërmjet të cilës ka bashkëlidhur dokumente justifikuese të ekzaminimeve mjekësore (të cilat pothuajse janë në gjuhën greke) duke justifikuar dhënien e efekteve të dorëheqjes përpara kohës së përcaktuara në nenin 65/3 të ligjit.

Në kohën e mbarimit të këtij relacioni, kur ku relacion ishte përpiluar dhe dorëzuar të gjithë anëtarëve, më datën 07.07.2020 vjen një tjetër kërkesë dhe dokumentacion shtesë nga gjyqtarja në fjalë, e cila me pak fjalë parashtron si më poshtë: “Unë e nënshkruara {...}, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kam depozituar në aplikim të nenit 64/a dhe nenit 65 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, me nr. prot. 2925, datë 24.06.2020, dorëheqjen time nga detyra e gjyqtarit dhe kam kërkuar deklarinimin me vendim të KLGJ-së të mbarimit të statusit të magjistratit. Me kërkesat e datës 26.06.2020 dhe datë 03.07.2020, për arsyet e mia personale dhe shëndetësore, kam kërkuar që efektet e mbarimit të statusit të magjistratit të vinin jo më larg se data 08.07.2020. Gjени bashkëlidhur kësaj kërkesë dokumentacionin justifikues shëndetësor. Po kështu, ju bëj më dije se çështja gjyqësore me nr. akti 2619 e 2019, me paditës “Shoqëria Tregtare “Digicom” sh.p.k., dhe objekti: përmbushje e detyrimit, ka përfunduar me vendimin e datës 07.07.2020. Bashkëlidhur një kopje të vendimit të shkurtuar për këtë çështje. Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj, mbetem në pritje të vendimmarrjes tuaj.”

Duke bashkëlidhur tashmë kësaj kërkesë një pjesë të dokumentacionit të administruar më parë në gjuhën greke por tashmë e noterizuar dhe që përmban një raport, rekomanduar edhe efekti i menjëhershëm i dorëheqjes, të 28.01 dhe 04.02.2015, mamografi 28.11.2019 të noterizuar dhe një mamografi shtesë ose interpretim mamografie dixhitale 12.01.2015, si dhe vendimin e shkurtuar me palë paditës “Shoqëria Tregtare “Digicom” sh.p.k., Shoqëria Tregtare “Lions Car Hire” sh.p.k. objekti:

përmbushje e detyrimit kontraktual, me anë të së cilës vërtetohet që gjyqtarja pothuajse ka mbaruar/ka shpallur këtë vendim duke paraqitur vendimin e shkurtuar.

Në këto kushte, pas analizës së këtyre akteve, rezulton që përfundimisht zonja {...}, për shkaqe shëndetësore ka kërkuar që dorëheqja mund të japë efekte, bazuar në pikën 3, të nenit 65, të Ligjit të Statusit, përpara datës 08.07.2020 duke e mbështetur këtë kërkim përveç të tjerave edhe në diagnozën e mjekësore të paraqitur.

Sipas nenit 65 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” “1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. 2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit. 3. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar dhe me miratim të Këshillit, dorëheqja mund të japë efekte përpara kohës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni”.

Instituti i dorëheqjes, është një akt vullnetar dhe nuk mund të jetë i kufizuar në kohë. Ai bazohet në vullnetin e lirë të magjistratit për të ndërprerë në çdo kohë vijimin e detyrës dhe për rrjedhim kontrata e shërbimit publik për këtë shkak përfundon. Magjistrati me shkresë të depozituar në Zyrën e Protokollit ka shprehur dëshirën për t’u dorëhequr duke qartësuar dhe siguruar vullnetin e tij përpara institucionit, si edhe ka kërkuar deklarinimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor të mbarimit të statusit, për shkak të dorëheqjes me efekte tashmë të përshpejtuar.

Me qellim që Këshilli të shprehet në lidhje me efektin e përshpejtuar të dorëheqjes, kjo e fundit duhet të përmbajë shkaqe të justifikuara të shoqëruara me prova të cilat motivojnë kërkesën e paraqitur. Në rastin konkret, gjatë përpilimit të këtij relacioni, provat ishin të shoqëruara ose në pjesën më të madhe ishin në gjuhën greke, por tashmë një pjesë e tyre janë administruar në gjuhën e noterizuar sipas ligjit shqiptar, por që datojnë në vitet e hershme 2015 dhe 2019.

Për rrjedhim në bazë të pikës 3 të nenit 65 të ligjit 96/2016 do të kërkoheshin që këto prova të përbënin shkak të justifikuar, duhet që ato të ishin të paktën në periudhën e



fundit ku të verifikohet gjendja shëndetësore, në bazë të së cilës është rekomanduar edhe efekti i menjëhershëm i dorëheqjes.

Kështu që, në këto kushte, të vetmen që mund t'ju propozoj është që të vijoj me relacionin siç e kam përgatitur edhe më parë draftin e vendimit, duke e trajtuar si një dorëheqje të zakonshme dhe duke propozuar:

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të dorëheqjes së saj nga ky status.

2. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 31.07.2020.

3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi në menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, përpara se ta kalojmë projekt-aktin në votim, kemi ndonjë diskutim nga kolegët?

Po, zonja Ukperaj!

**Brikena Ukperaj:** Fillimisht unë kam një pyetje për relatorin.

Është dorëheqje e motivuar apo jo? –Sepse thua që deklarohet mbarimi i statusit për dorëheqje të motivuar dhe pastaj efektet i lidh me mbarimin e muajit pasardhës. Këtë gjë për ta sqaruar cili është qëndrimi.

I referohem gjithmonë relacionit sepse the që do t'i përmbahem relacionit të mëparshëm.

**Alban Toro:** Atëherë, zonja në fjalë e ka kërkuar që për shkaqe të justifikuara me kërkesë të motivuar, kërkon miratimin e Këshillit për dorëheqje dhe efektet e saj i kërkon të përshpejtuara, pra përpara rrjedhës normale të cilën ka përcaktuar ligji, pra në fund të

muajit pasardhës (i bie në korrik, 31 korrik), e cila po të lihej në gjendje të lirë, do të hynte në fuqi kjo dorëheqje dhe për shkakun që ajo ka paraqitur disa shkaqe të justifikuara shëndetësore, pra provat e gjendjes së saj shëndetësore, ajo pretendon që këtë dorëheqje ta konsiderojë me efekte të përshpejtuara.

**Brikena Ukperaj:** Megjithëse përgjigjen e pyetjes e mora disi, në fakt unë dua të jap argumentin tim lidhur me vlerësimin për çështjen, jo vetëm referuar provave të paraqitura nga gjyqtarja, por referuar edhe në standardin që ne kemi mbajtur deri tani, për atë që e quajmë dorëheqje të motivuar.

Referuar standardeve të mëparshme, shkaqet që lidhen me gjendjen shëndetësore të gjyqtarëve janë konsideruar të tilla që mund të çojnë në dorëheqje të motivuar, pra që efektet e dorëheqjes të mund të vinin më përpara se afati normal i mbarimit të muajit pasardhës.

Referuar provave të paraqitura nga gjyqtarja, pa u ndalur në mënyrë të detajuar tek secila prej tyre sepse përbëjnë edhe të dhëna sensitive, që lidhen me jetën private të saj, unë konstatoj që ka një ecuri mjekësore që kërkon ekzaminime të vazhdueshme që fillojnë nga viti 2015 deri në vitin 2019.

Në këtë kuadër, duke qenë se gjyqtarja e lidh konkretisht mbarimin e statusit të saj dhe kërkon efekte të përshpejtuara që lidhen pikërisht me gjendjen e saj shëndetësore, duke konsideruar provat e mjaftueshme për të arritur atë nivel që ne kemi vlerësuar si kërkesë të motivuar, unë vlerësoj që mbarimi i statusit të gjyqtares, duhet të trajtohet i tillë, me efekte të përshpejtuara. Pra dorëheqja duhet të trajtohet e motivuar, për shkaqe shëndetësore, por efektet e dorëheqjes nuk do të vijnë për këtë shkak në datën 31.07 por në datën 08.07 sikundër gjyqtarja argumenton në kërkesën e saj. Ndryshe nga relatori, kam mendimin që kërkesa e gjyqtares duhet të trajtohet në kuadër të nenit 65, pika 3 të ligjit për Statusin dhe në këtë kuadër kam edhe propozimin përkatës lidhur me përmbajtjen e projekt-aktit.

Mund ta lexoj, apo ka ndonjë diskutim nga kolegët?

**Naureda Llagami:** Atëherë, ftoj njëherë kolegët përpara se zonja Ukperaj të bëjë propozimin konkret.

**Alban Toro:** A mundem të flas?

**Naureda Llagami:** Po, Alban!

**Alban Toro:** Në lidhje me provueshmërinë e shkaqeve të justifikuara, ky Këshill tashmë ka vendosur, jo më larg por përpara dy javësh, në mos u gabofsha, një standard (por edhe më parë), kur provat kanë qenë të tilla që nuk provonin shkakun, i ka mohuar gjyqtarit një kërkesë (pra kur bazohen në kërkesa mbi gjendjen shëndetësore), i ka refuzuar kërkesën për të mos marrë çështje të caktuara nga gjykata të ndryshme nga ku ata gjykonin. Kështu që unë nuk shoh ndonjë ndryshim të veçantë në lidhje me provueshmërinë e shkaqeve të justifikuara. Fakti që ka pasur një ecuri të sëmundjes në 2015-2019, do të duhej të shoqërohej të paktën edhe me një kontroll nga ana mjekësore apo një rekomandim të mjekut sepse ne nuk jemi të aftë të vendosim pa një rekomandim mjekësor, në lidhje me ecurinë e kësaj sëmundjeje dhe më pas të bënim një vendimmarrje. Për të njëjtat shkaqe, një gjyqtare të mëparshme ne ia kemi refuzuar kërkesën. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Atëherë, faleminderit zoti Toro!

Kemi ndonjë diskutim tjetër nga kolegët?

Nëse jo, atëherë duke qenë se zonja Ukperaj ka një propozim...

**Brikena Ukperaj:** Mund ta lexoj propozimin zonja Kryetare?

**Naureda Llagami:** Po! Ndryshimin që kërkoni juve.

**Brikena Ukperaj:** Në fakt, propozimi im është ndryshimi i të gjithë disponimit të Këshillit. “Në zbatim të nenit 61 të Ligjit nr. 115/2016 dhe nenit 65 pika 3, të Ligjit nr. 96/2016, propozoj që të deklarohet mbarimi i statusit të magjistratit për znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të dorëheqjes së motivuar të saj nga ky status.

2. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 08.07.2020.

3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Ukperaj!

Atëherë, për procedurë do hedhim fillimisht në votim propozimin e bërë nga zonja Ukperaj, më pas propozimin e relatorit.

**Maksim Qoku:** Kundër.

**Brunilda Kadi:** Unë jam pro dhe kam një arsyetim paralel me atë që thotë Brikena, disi ndryshe. Mendoj që akti i dorëheqjes së gjyqtarit është akt i vullnetshëm dhe asnjë gjë nuk mund ta ndalojë gjyqtarin të japë dorëheqjen. Motivimi, që është një situatë e ndryshme nga ajo që parashikon normalisht dispozita, është përsëri si një rrethanë që ligji mendoj se e ka vënë në favor të magjistratit dhe kur ai deklaron që e do mbarimin e statusit apo dhënien e efekteve më përpara se data që i jep mundësi ligji, është vullneti i tij dhe ne nuk e deformojmë dot, nuk kemi asnjë të drejtë që ta refuzojmë. Motivin e deklaron, dhe për mua nuk ka nevojë që të provohet dhe nuk jam dakord me diskutimin e nivelit të provës. Ai deklaron një motiv. Nëse Këshilli e vlerëson që është një motiv i arsyeshëm dhe bën sens, e pranon. Unë mendoj se është i tillë, e deklaron vet gjyqtari, dhe votoj pro që dorëheqja të japë efektet më përpara se data 31 korrik, që është data e fundit e muajit pasardhës. Pra votoj pro propozimit të Brikenës.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Kundër.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Kundër. Domethënë unë jam dakord për deklarimin e mbarimit të statusit për shkak të dorëheqjes, por vlerësoj bazuar edhe në shkaqet e paraqitura edhe në dokumentacionin bashkëlidhur se nuk ndodhemi në kushtet e nenit 65, pika 3 të ligjit për Statusin. Pra lidhur me propozimin e Brikenës jam kundër.

**Erjon Muharremaj:** Pro. Në vijim të qëndrimit që kam mbajtur edhe në mbledhjen e datës 02.07.2020.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro sepse zonja {...} vërtet ka probleme shëndetësore.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli me shumicë votash miraton propozimin e bërë nga zonja Ukperaj, pra lidhur me mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, znj. {...}, Këshilli vendosi:

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të dorëheqjes së motivuar të saj nga ky status.

2. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 08.07.2020.

3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Atëherë, nëse nuk keni ndonjë çështje tjetër, mbledhjen e konsideroj të mbyllur. Faleminderit, për prezencën. Ditë të mbarë!

\* \* \*

(Pika 2 shtesë e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**